

Fjalim i deputetit Vangjel Dule

03.07.2023

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Më sa duket, sëmundja e parlamentarëve për të mos qenë të pranishëm në seanca, të paktën, në një shumicë të caktuar, ka prekur edhe krerët e institucioneve të drejtësisë. Është dita e tyre në Kuvend, 1 në 365 ditë dhe, fatkeqësisht, nuk janë të pranishëm për të dëgjuar atë çfarë legjislatorët e vendit mendojnë dhe vlerësojnë, edhe në emër të atyre që përfaqësojnë për aktivitetin e tyre.

Pa dyshim, reforma në drejtësi, nga çdo këndvështrim, si ai politik, financiar, i burimeve njerëzore, i mbështetjes së partnerëve tanë, është investimi më strategjik i këtyre 32 vjetëve. Edhe unë jam një nga ata parlamentarë që kanë votuar shumicën dërrmuese të ndryshimeve kushtetuese, të ligjeve dhe të akteve për reformën në drejtësi.

Sot dëgjuam statistika, dëgjuam edhe citime nga raportet ndërkombëtare, por unë do të dëshiroja të dëgjoja diçka tjetër: si ka funksionuar ajo që kemi prodhuar ne me veprën tonë legjislative? Ku kanë qenë anët e forta dhe të dobëta? Ku kanë dhënë rezultate dhe ku kërkohet më? Çfarë duhet nga legjislativi? Çfarë duhet nga ekzekutivi? Pra, është momenti t'i shikojmë me detaje.

Është e vërtetë se ka vlerësim në raportet e partnerëve ndërkombëtarë, por nuk duhet të harrojmë për asnjë moment se në matjet e opinionit publik që ekzistojnë në vendin tonë, perceptimi publik nuk është ledhatues për organet e reja të drejtësisë. Natyrisht, ka vlerësim, por në të njëjtën kohë ka edhe skepticizëm, edhe zhgënjim. Këtu duhet të debatojmë, por jo formalisht, sa për të kaluar seancën, por për të dalë në konkluzione dhe për të ndërmarrë veprime.

Platoni thoshte se padrejtësia, ose forca më e madhe, më e keqe e padrejtësisë, është kur kemi drejtësi të pretenduar, inekzistente për t'u pretenduar. Ky është pikërisht hendeku, të cilit ne duhet t'i shmangemi me çdo kusht.

Personalisht nuk kam pasur përvoja indirekte me drejtësinë, por kam ndjekur një çështje sistematikisht, atë të pronave, dhe mund të them se, në lidhje me veprën e organeve të reja të drejtësisë, në lidhje me pronën, nuk u takoj optimistëve. Ka ende patogjeni të trashëguara nga sistemi i kaluar, duhet vënë dorë, duhet ndryshim. Drejtësia e re është ngritur që të japë cilësi në drejtësi dhe drejtësi në kohë. Këto janë sfidat që kërkojnë përqendrimin e energjive dhe të përpjekjeve të organeve të dala nga reforma në drejtësi.

Ka edhe një aspekt tjetër. Edhe drejtësia e re, fatkeqësisht, individë apo segmente, nuk i kanë shpëtuar asaj që qysh në fillim synonte reforma në drejtësi krahas të tjerave: shpëputjes së ndikimit politik në të. Natyrisht, nuk dua të fajësoj të gjithë sistemin, e kam për segmente dhe për individë të caktuar.

Më lejoni që, shkurtimisht, për çështjen e kryetarit të Bashkisë së Himarës, zotit Beleri, t'ju përmend shkeljet apo zinxhirin e shkeljeve në mendime dhe në veprime të segmenteve të drejtësisë, që vijnë për të përmbushur një mision politik të ngarkuar nga Kryeministri Edi Rama.

1. Gjatë hetimit paraprak, hetimi është kryer nga prokuroria e Vlorës, e cila nuk kishte kompetencë lëndore për regjistrimin e procedimit penal, në bazë të Kodit të Procedurës Penale.
2. Është autorizuar përgjim nga prokuroria, në shkelje të kriterëve të ligjit, pasi shtetasi Alfred Beleri nuk ka qenë person ndaj të cilit zhvilloheshin hetime.
3. Vendimi i gjykatës, që e ka vlerësuar të ligjshëm përgjimin, është në shkelje të ligjit, pasi është bërë jashtë afatit ligjor.
4. Është përdorur si bashkëpunëtor për të kryer veprime provokimi për shitblerje votash, një subjekt i dënuar për veprën penale “mashtrim”, dëshmitar ky që është i pabesueshëm sipas Kodit të Procedurës Penale.
5. Përgjimi ambiantal i kryer nga bashkëpunëtori i policisë nuk ka orën e kryerjes së bisedave dhe nuk përputhet në asnjë element me procesverbalin e vëzhgimit dhe ndjekjes, i kryer dhe i firmosur nga 15 oficerë të Policisë Gjyqësore, gjë që e bën të dyshimtë përgjimin.
6. Janë ndjekur dhe vëzhguar nga policia jo vetëm ata që ka autorizuar prokuroria, por edhe zyra elektorale dhe persona të tjerë të papërfshirë në hetime. Pra, penalizim i politikës.
7. Arrestimi në flagrancë është kryer në shkelje të ligjit. Edhe vetë oficerët e Policisë Gjyqësore nuk kanë qenë në dijeni për shkaqet për të cilat u kap në flagrancë shtetasi Dhionisios Alfred Beleri, në një kohë kur kishim rastin e një deputeti të Partisë Socialiste, koleg i mazhorancës, që në mënyrë të paskrupullt kishte shpallur se aplikimet për ligjërimitin e pronave do të bëheshin në zyrën partiake. Kjo është dëshmi ekstravagante e korrupsionit paraelektoral, por organet e drejtësisë i mbyllën sytë.
8. Bashkëpunëtori i policisë nuk është ndaluar menjëherë pas veprimit të dyshuar për shitblerje votash, por 8 orë pas këtij veprimi ka dorëzuar në polici paratë që pretendon të jenë dhënë nga i arrestuari tjetër, çka e bën të dyshimtë që paratë të jenë dhënë nga i arrestuari.
9. Lista e votuesve, që mendohet se po blihej nga të ndaluarit, e dorëzuar nga bashkëpunëtori i policisë, nuk ka qenë asnjëherë në posedim të të ndaluarve.
10. Prokurorisë i është kërkuar tri herë me shkrim të dëgjohen përgjimet nga mbrojtësit ligjorë, bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurave Penale, por nuk ka dhënë përgjigje, në shkelje të hapur të dispozitave të Kodit të Procedurave Penale.

Gjatë gjykimit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, midis 31 procedimeve penale të regjistruara gjatë zgjedhjeve të 14 majit, masa e sigurimit “arrest me burg” është caktuar vetëm ndaj shtetasit Dhionisios Alfred Beleri.

Shtetasi Dhionisios Alfred Beleri është i vetmi kandidat dhe kryetar i zgjedhur i bashkisë, i arrestuar si i dyshuar se një nga mbështetësit e tij mund të ketë kryer shitblerje votash, në 32 vjet.

Gjatë gjykimit në Apelin e Posaçëm, gjykata e refuzoi kërkesën e të arrestuarit se nuk ishte dënuar, pasi dënimi i dhënë në vitin 2006 ishte rehabilituar, në kundërshtim me nenin 69 të Kodit Penal, me praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe me Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Po ashtu, gjykata, duke marrë përsipër rolin e prokurorisë, e rëndoi pozitën e ankuesit, duke ia rënduar akuzën, në shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit. Por qershia mbi tortë është fakti që ai nuk u lejua të bënte betimin as në kushtet e shoqërimit policor, as në mjediset e ndalimit, ndërkohë që kemi pasur raste kur deputetë të ndaluar kanë ardhur për të votuar në seancë plenare ose janë betuar në kushtet e ndalimit.

Ne nuk e duam një drejtësi të tillë selektive dhe me dallime.

Faleminderit!